



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.09.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NARA BIOTICS" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material stomatologjik", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-8446-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-128 -121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " NARA BIOTICS " SH.P.K. e dt.28.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material stomatologjik", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-8446-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-128 -121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 27.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 27.09.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Arsyetim

Me dt.28.09.2023, Operatori Ekonomik " NARA BIOTICS " SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me material stomatologjik", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-8446-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-128 -121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse ju keni prezantuar dëshmi nga ATK-ja, që janë transaksione të përgjithshme por nuk keni ofruar transaksione bankare siq është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu kontratat e prezantuara nga ju nuk mund të merren për bazë sepse në të gjitha kontratat thuhet " *kjo referencë është e vlefshme nga dt.15.08.2021 deri me 30.04.2023*", ndërsa te neni 4 thuhet "kjo kontrata hyn në fuqi me dt.02.05.2023", që i bie të jetë datë pas lëshimit të referencës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

për: Xhaferr

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës

